

FTESË PËR OFERTË

Organizata:	HANDIKOS (Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës)
Projekti:	“Promovimi i gjithëpërfshirjes dhe shtrirjes së proceseve konsultative për reformat e qeverisjes dhe administratës publike në sektorin e aftësisë së kufizuar në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal – Kosova gjithëpërfshirëse”.
Titulli i kontratës:	Kontratë për pajisje të vlerësimit të qasjes
Lokacioni:	Kosovë
Data e publikimit:	17/03/2022
Data e mbylljes:	24/03/2022
Data e vlerësimit të ofertave	24/03/2022
Email-i:	handikos@handi-kos.org

1. PËRMBLEDHJE

HANDIKOS (Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës) është themeluar në vitin 1983 me qëllim kryesor arritjen e njohjes dhe pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. HANDIKOS lobon dhe avokon në mënyrë aktive në nivel lokal dhe qendror për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim të krijimit të një mjedisi gjithëpërfshirës përmes rritjes së mundësive të punësimit, përmirësimit të qasjes në arsim, përfshirjen e PAK në skemat e mirëqenies sociale dhe sigurimeve shoqërore, si dhe përmirësimin e qasjes fizike.

HANDIKOS, në partneritet me Disability Partnership Finland, Threshold (OJQ finlandeze), Shoqatën Kosovare e të Shurdhërve, si dhe Shoqatën e të Verbërve të Kosovës, aktualisht po zbaton projektin e financuar nga BE të quajtur “Promovimi i gjithëpërfshirjes dhe shtrirjes së proceseve konsultative për reformat e qeverisjes dhe administratës publike në sektorin e aftësisë së kufizuar në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal – Kosova gjithëpërfshirëse”. Në kuadër të këtij projekti është planifikuar realizimi i punëtorive lidhur me qasjen, për çka HANDIKOS është duke kërkuar ofertues për disa pajisje të nevojshme për realizimin e trajnimit (Kërkesa për kuotim e bashkangjitur).

2. KRITERET PËR PËRZGJEDHJE:

Kriteret për përzgjedhjen e ofertave më të përshtatshme për shërbimet e nevojshme janë:

- Dorëzimi i dokumentacionit të plotë;
- Ofertimi për të gjitha pajisjet e kërkuara;
- Çmimi më i lirë.



Funded by
the European Union



3. DOKUMENTET PËR DORËZIM DHE PËRMBAJTJA E OFERTËS:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit;
- Çmimet e shërbimeve në euro duke mos përfshirë TVSH-në (HANDIKOS është e liruar nga TVSH prandaj çmimet duhet të jenë pa TVSH);
- Oferta financiare (kërkesa për kuotim në linkun e bashkangjitur e ndarë me çmime për secilën pajisje; <https://docs.google.com/spreadsheets/d/1m5f05zjz2QYzqTM61V3j3kP0bMDGdBbn/e/dit?usp=sharing&ouid=108334723418172893571&rtpof=true&sd=true>);
- Oferta (kërkesa për kuotim) duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur/apo me logo zyrtare;

6. UDHËZIM PËR OFERTUESIT

Ofertuesit janë të mirëpritur të dorëzojnë aplikacionet e tyre në handikos@handi-kos.org, me mbishkrimin: “Oferta_Pajisje”, më së voni deri më 24/03/2022 ora 14:00. Propozimet e marra pas afatit të caktuar nuk do të merren në konsideratë.

Kjo ofertë është e hapur për të gjitha bizneset që janë të regjistruara ligjërisht dhe mund të ofrojnë shërbimet e kërkuara.